



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PERGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TE BURIMEVE
NJEREZORE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

RELACION

PËR

“MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR.17, DATË 18.1.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/5, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP 23934.7 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/12, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 2974.5 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/912, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP 85836 M²; NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRETH KOMPLEKSIT TË STADIUMIT “SKËNDERBEU” NË KORÇË, PËRFSHIRË STADIUMIN, QË DO TË NËNSHKRUHET MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË KORÇË, AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SI DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”

Me vendimin nr.17 datë 18.01.2023 të Këshillit të Ministrave është vendosur ngarkimi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qëndror blerës për realizimin e konkursit të projektimit për projektidete e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës.

Pas përfundimit të fazës së përzgjedhjes së projektit fitues nëpërmjet një konkursi ndërkombëtar të projektimit për rikonceptimin e kompleksit sportiv Skënderbeu, tashmë kemi hyrënë një fazë vijuese të vendosjes në dispozicion të pronave në pronësi të Bashkisë Korçë dhe nënshkrimit të marrëveshjes ndërinstitutionale për zhvillimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit “Skënderbeu” në Korçë, përfshirë Stadiumin.

Bashkia Korçë, si institucion përgjegjës për zgjedhjen dhe realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e komunitetit, në funksion të qeverisjes së efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, bazuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore, dhe referuar VKM-se 1532 date 19.11.2008 “Përmiratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” ka në pronësi pasuritë me nr. 1/5, nr. 1/12 dhe

1/912 ZK 8561 dhe ka interes për zhvillimin e zonës duke vendosur në dispozicion të zhvillimit të projektit këto prona.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 gërma e) (*Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak në raport me pronat e Bashkisë Korçë*) dhe referuar VKM-së nr.17 datë 18.01.2023 të sipërcituar, Këshilli Bashkiak Korçë duhet të shprehet për vendosjen në dispozicion të projektit të pronave që preken nga rikonceptimi i kompleksit sportiv Skënderbeu.

Pronat që preken nga ky projekt janë:

1. Pasuria nr.1/5 ZK 8561 e llojit “Terren Sportiv” me sipërfaqe 23934.7 m² truall nga të cilat 323.3 m² ndërtesë (Stadiumi Skënderbeu) në pronësi të Bashkisë Korçë.
2. Pasuria nr. 1/12 ZK 8561 e llojit “Truall” me sipërfaqe 2974.5 m² nga të cilat 2258 m² ndërtesë (Pallati i Sportit Tamara Nikolla) në pronësi të Bashkisë Korçë.
3. Pasuria nr.1/912 ZK 8561 e llojit “Truall” me sipërfaqe 85836 m² truall nga të cilat 250 m² ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Korçë.
(*Bashkangjitur këtij materiali po ju vendosim në dispozicion kartelat e pasurive të sipërcituara*)

Këto tre prona do të vendosen në dispozicion të projektit me emërtim “Zhvillim i zonës multifunkionale përreth kompleksit të stadiumit Skënderbeu në Korçë, përfshirë Stadiumin”, bazuar kjo në Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.17 datë 18.01.2023.

Për realizimin e këtij projekti Kryetari i Bashkisë Korçë duhet të autorizohet për nënshkrimin e marrëveshjes me palët e tjera që do të investohen në këtë projekt, të cilat janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) e cila merr përsipër marrjen e nismave ligjore të nevojshme në lidhje me projektin dhe zhvilluesin e tij apo përcaktimin e përgjegjësive të tjera me qëllim zhvillimin e zonës objekt marrëveshje përgjatë fazave të projektit, në përputhje me përcaktimet ligjore.
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) e cila vë në dispozicion të zhvilluesit çdo dokumentacion të nevojshëm nga konkursi i projektimit, ndjek dhe vlerëson përputhshmërinë e projektit me planet e miratuara dhe standardet e planifikimit të territorit, duke këshilluar dhe koordinuar procesin për zbatimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e qendrueshëm.
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) si zhvillues i projektit i cili merr përsipër:
 1. të hartojë analizat dhe studimet e nevojshme;
 2. koordinojë me Bashkinë dhe aktorët e tjerë për kërkesat/nevojat e tyre në funksion të projektit si dhe autorizimin për aplikimet e nevojshme nga FSHZH;
 3. të ngrejë grupe pune duke angazhuar burimet e veta, të entiteteve në varësi të tij apo ekspertizë të jashtme etj.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bashkisë Korçë në këtë marrëveshje janë të vendosura në dispozicion të

projektit pronën e përshkruar më sipër, si dhe të informojë zhvilluesin (FSHZH) për kërkesat dhe nevojat përkatëse me qëllim marrjen në konsideratë të tyre gjatë detajimit të projektit.

Si konkluzion, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”; ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; ligji 79/2017 “Për sportin”; VKM nr.17 date 18.01.2023 “Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës”; VKM 1532 date 19.11.2008 “Përmiratimin e listëspërfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë, të miratojë vendosjen e pronave me nr. **1/5 ZK 8561** e llojit “Terren Sportiv” me sipërfaqe 23934.7 m² truall nga të cilat 323.3 m² ndërtesë (**Stadiumi Skënderbeu**); nr. **1/12 ZK 8561** e llojit “Truall” me sipërfaqe 2974.5 m² nga të cilat 2258 m² ndërtesë (**Pallati i Sportit “Tamara Nikolla”**) dhe nr. **1/912 ZK 8561** e llojit “Truall” me sipërfaqe 85836 m² truall nga të cilat 250 m² ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Korçë, në dispozicion të projektit “**Zhvillim i zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit Skënderbeu në Korçë, përfshirë Stadiumin**” projektit të shpallur fitues nga AKPT; dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Korçë për nënshkrimin e marrëveshjes ndër-institucionale për zhvillimin e projektit; marrëveshje shumëpalëshe midis Ministrisë së Arsimit; Bashkisë Korçë; Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (zhvillues i projektit).

Drejtoria e Përgjithshme Juridike

D.P.K.ZH.T

ANXHELA DISHNICA QERAMIXHI

ZHANETA LUBONJA

KRYETARI I BASHKISE

SOTIRAQ FILO